

HUAZIMET SLLAVE JUGORE NË GJUHËN SHQIPE DHE ATO SHQIPE NË GJUHËT SLLAVE

Ardhja e sllavëve në Gadishullin Ballkanik pati pasoja për popujt e kësaj treve. Në radhë të parë, pati pasoja të mëdha politike e kulturore për vetë sllavët, sepse ata, përveç se u përzierën me popullsitë autoktone iliro-romane, u futën përgjithmonë edhe në sferën e kulturës e të kishës bizantine. Kështu që sllavët e Ballkanit patën një zhvillim të ndryshëm nga ai i sllavëve të viseve të tjera të Europës. Edhe gjuhët e tyre u bënë gjuhë ballkanike. Këto janë kroatishtja e serbishtja në perëndim, slovenishtja në veriperëndim e bullgarishtja në lindje, që të katërta gjuhë sllave jugore.

Dyndja e sllavëve në Ballkan vijoi nga shekulli V deri në shekullin VII të erës sonë. Me ardhjen e sllavëve në këtë periudhë mori fund edhe dyndja e popullsive indoeuropiane në trevat ballkanike nga viset përtej Danubit. Për të parën herë, sllavët u shfaqën në këto anë në vitin 493, në kohën e perandorit bizantin Anastasi I. Në fillim ata u dukën me hope, vinin e tërhiqeshin, por, pas largimit të gotëve për në Itali, ata zunë vend në këto anë.

Në fillim, fiset sllave të Ballkanit nuk u paraqitën të ndara me emra kombëtarë të veçantë, ata quheshin përgjithësisht sllavë. Aty nga viti 610 na u shfaqën emra serbë e kroatë. Këta u vendosën në krahinat perëndimore të gadishullit gjer në brigjet e Adriatikut. Sa për bullgarët, duhet theksuar se emri i tyre në krye ka qenë i një populli jo i familjes sllave, por i grupit gjuhësor fino-ugrik, ku bëjnë pjesë edhe hungarezët. Ata u shkulën në shekullin VII nga anët e detit Kaspik nën Khanin Asparuh (Isperih) dhe erdhën e u ngulën në Bullgari e në Traki. Kjo ishte një mbishtresë e hollë etnike, që me kohë u përzje me popullsinë sllave të vendit. Nga kjo përzjerje u formua një popull i ri e me gjuhë sllave, bullgarët, të cilët mbajtën emrin e bullgarëve të Azisë, që quhen edhe protobullgarë (bullgarët e parë).

Bullgarët kanë themeluar në Mesjetë dy mbretëri. E para u bë për disa shekuj më e forta në Gadishullin Ballkanik dhe arriti kulmin e saj nën carin Simeonin (893-927) dhe pati luftëra të gjata

me Perandorinë Bizantine. Car Mihaeli III e shtriu sundimin e tij edhe mbi krahinat perëndimore, duke përfshirë edhe Shqipërinë e sotme, e duke dalë gjer në Adriatik. Mbretëria e parë bullgare në pjesën e saj perëndimore doli shtet më vete në vitin 972, me kryeqytetin në Ohër, duke përfshirë edhe tokat shqiptare. Kjo u mposht më 1014, kur perandori bizantin Vasilios II, bullgarvrasësi, mundi Car Samuelin dhe mori fund në vitin 1018. Më 1187, vëllezërit Pjetër e Ivan Asen themeluan, me ndihmën e rumunëve, të dytën mbretëri bullgare me kryeqytet Tërnovën. Kësaj i dhanë fund osmanët më 1393.

Për sa u përket serbëve, vatra e shtetit të parë dhe e sundimit politik u bë krahina e Zetës në Malin e Zi të sotmin. Në shekullin XII, princi Stefan Nermanja themeloi në këto anë dinastinë e Nemanjiqëve, e cila zotëroi përmbi Serbi e mbi viset përreth për afro 2 shekuj me radhë. Mbretërit e kësaj dere rregulluan edhe gjendjen juridike të shqiptarëve e të vllahëve të shtetit të tyre. Shteti serb i Mesjetës arriti kulmin me car Stefan Dushanin (1331-1355) Ky car e shtriu pushtetin e tij edhe mbi disa krahina të Shqipërisë e të Greqisë veriore, gjer në Thesali. Me vdekjen e tij, mbretëria serbe ra poshtë. Kundër saj u ngritën dinastët e krahinave të ndryshme të Shqipërisë, si Balshajt në Veri, Gjin Bua Shpata në Jug. Me luftën e Fushë-Kosovës më 1389 mori fund mbretëria serbe e Mesjetës nën pushtetin e osmanëve.

Këto marrëdhënie të shqiptarëve me sllavët, që zgjatën afërsisht tetë shekuj me radhë, kanë lënë gjurmët e tyre edhe në gjuhë. Me lidhjet historike e gjuhësore sllavo-shqiptare janë marrë një varg dijetarësh, historianë e gjuhëtarë. Nga historianët le të përmendim dijetarin rus të shekullit XIX V. Mkushev, autori i veprës "Monumenta historica Slavorum meridionalium". Kostantin Jirçeku në veprat e tij u ka kushtuar vëmendje të veçantë marrëdhënies shqiptare-sllave, sidomos te veprat "Rumanët në qytetet e Dalmacisë gjatë mesjetës", "Historia e Serbëve" dhe "Shteti e shoqëria në Serbinë mesjetare". Edhe albanologu Milan Shuflai (M. Von Sufflay) me veprat e tij "Serbët e Shqiptarët" (1925) dhe "Qytete e kala të Shqipërisë kryesisht gjatë kohës së mesme (1924) i ka gjurmuar këto marrëdhënie historike. Nga gjuhëtarët le të përmendim F. Miklosichin, që në veprën e tij "Elementet sllave të shqipes" (1870) hodhi themelet për studimet sllavistike në lidhje me shqipen. Punën e tij e vijuan dhe e çuan më tutje nëpër studimet e tyre të ndryshme dijetarë,

si: G. Majeri (G.Meyeri), N. Jokli, P. Shoku, H. Bariçi. Në "Fjalorin etimologjik të gjuhës shqipe" në Strasburg, G. Majer nga 5140 fjalë që mori në analizë, 540 fjalë i nxori të burimit sllav. Vepra që përmbledh në një sintezë ndikimin sllav në gjuhën shqipe, është ajo e sllavistit rus A.M. Shelishçev me titullin "Sllaviaanskee naselenie v Albanii"(Sofje, 1931). Në këtë vepër studiohet problemi i marrëdhënieve sllavo-shqiptare nga ana e gjuhës dhe nga ana e historisë dhe e raporteve shoqërore. Sipas këtij dijetari, këto raporte janë të tilla, që sllavët zunë fushat dhe luginat e lumenjve, shqiptarët mbetën banorët e malësisë dhe të viseve të larta.

Në epokën tonë, studimet më të rëndësishme për huazimet sllave në gjuhën shqipe dhe huazimet shqipe në gjuhën sllave i kanë kryer në veprat e tyre gjuhëtarët e shquar Eqerem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Idriz Ajeti, Jani Thomai, Safet Hoxha, Xhevat Lloshi, si dhe studiuesit e gjuhës shqipe Anila Omari, Xhelal Ylli etj.

Huazimet sllave të shqipes i kanë grupuar në këto fusha: shtëpia, oborri, orenditë shtëpiake, bujqësia, blegtoria (bagëtia, bota shtazore), bletaria, ujërat, peshkimi, mulliri, dërstila, zejtaria, veshmbathja, jeta shoqërore, administrata, tatimet, e drejta ndëshkimore, disa dukuri të jetës botore e kulturore, toka e pamjet e saj, sidomos toponomastika, fjalë pa ndonjë lidhje me inovacione materiale, trupi i njeriut. Më poshtë po përmendim disa shembuj nga këto grupe fjalësh:

Shtëpia, oborri, orenditë shtëpiake: strehë, pod (kat), treme (hajat), prag, grazhd, stol, kyç, oborr, kotec, kosh, kovë, vedër, koritë, sitë, kulaç, mesnik, gërmadhë, godinë.

Bujqësia: branë, lesë, lopatë, kosë, brazdë, ograjë, prashit, vadit, vlagë, pleh, kapticë, sanë.

Bimë, pemë e perime: kastravecë, molikë, repë, tis.

Blegtoria, bota shtazore: blegë (bareshtë), dele rudë, bravare (dele shtëpie), govadar, govedar (lopar), çelnik (kryetar i barinjve), stopan, travok (gjizë), kokosh, mace, maçok, zhabë, sokol, harabel, esh (iriq), piavicë, karkalec, molë, patë.

Bletaria: korube, krinë, luzinë, maticë, matkë, roit, bleta.

Ujërat, peshkimi: lopatë, vozit, mrezhë (rrjetë), vllak (lloj

rrjete), fllad.

Emra peshqish: krap, belevicë, pestrovë.

Mulliri, dërstila: dërstilë, koritë, kosh, valanicë.

Zejtaria: drugë, kaç (endës), zdrugë, topër (sëpatë e vogël), kovaç, potkua, gozhdë, çekan, çekiç, verigë (farkëtaria).

Veshmbathja: opingë, opangë, rizë, rubë.

Jeta shoqërore, administrata, ushtria, e drejta ndëshkimore: zakon, porotë (zhuri prej 24 vetësh); bujar, rob, robinjë, dobi, grabit, plaçkë, nevojë, krahinë, vojvodë, kasnec, padis, pojak, stan; taksa: carinë, porez, gjobë, mitë, pushkë.

Disa dukuri të jetës botore e kulturore: porositë, merë (masa), vazhdë, vazhdoj, darovit, gosti, gostit, bashtinë, probatin, rod, kume, avitem, godit, bisedë, bisedoj, i vobektë, i dobët, dobi.

Toka: rrafsh, log, rudinë, lëndinë, breg, rrëke, llom, llum, glinë.

Fjalë pa ndonjë lidhje me inovacione materiale: çudit, habit, korit, mërzit, neverit, zbraz.

Trupi i njeriut: trup, kockë, gërlac, gërlan, grusht, memec, vërsë (moshë), vërsnik.

Duke i vështruar këto huazime, që janë vetëm një pjesë e elementit sllav të shqipes, del se ato janë kryesisht në fushën e kulturës materiale e të ekonomisë shtëpiake, veçanërisht në bujqësi e blegtori, në veglat shtëpiake, në zejtari etj.

Nga burojnë sllavizmat e shqipes! Sipas rrethanave historike, me përhapjen e ndikimit bullgar në Shqipërinë e mesme e jugore dhe të sferës serbe në Shqipërinë veriore, mund të thuhet se huazimet sllave që gjenden në dialektet e atyre krahinave, janë marrë prej bullgarishtes, sllavizimet e gegërishtes veriore prej serbishtes e kroatishtes. Një ndarje e tillë bëhet kryesisht sipas kriterit të rrethanave historike sesa sipas dëshmisë së gjuhës. Sepse po të nisemi nga të dhënat gjuhësore, shohim se serbishtja, kroatishtja dhe bullgarishtja, si gjuhë sllave jugore dhe mjaft të afërta midis tyre, kanë një shumicë fjalësh me të njëjtën formë. Në këto kushte, për shumë fjalë sllave, madje për shumicën prej tyre, gjuhësisht nuk mund të thuash se prej cilës nga këto tri gjuhë burojnë. Të tilla janë, p.sh., **kulaç, gërmadhë, glinë, kosh,**

koritë, mrezhë, vllak, zakon etj. Ndërkaq, ka raste ku mund të bëhet një dallim nga ana gjuhësore, atëherë kur trajta serbe e kroate ndryshon nga ajo e bullgarishtes. Kështu p.sh., vokali *b* i reduktuar i sllavishtes është hapur në serbisht e kroatisht *a*, në bullgarishten ka dhënë *i*, pra në serbisht e kroatisht është fjala *opanak pank*, bullg. *opinci*. Rrjedhimisht, në Shqipërinë veriore thuhet *opangë* nga serbishtja e kroatishtja, kurse në Shqipërinë jugore *opingë* nga bullgarishtja etj. Raporti *i:a* shfaqet edhe tek emri i krahinës Dibra. Ky reflekton trajtën bullgare *dbbrb*, ndërsa në serbisht dhe kroatisht paraqitet *Dabar* e *Debar*.

Po kështu duhet të ketë në gjuhën shqipe disa elemente leksikore që nuk rrjedhin as prej bullgarishtes e as prej serbishtes e kroatishtes, po që ndodh të kenë nga një shtresë sllave më e vjetër. Një rast i tillë është fjala *grusht*.

Ndër huazimet sllave të shqipes vërehet se ka disa derivacione e zgjerime në gjuhën shqipe, që janë formime të brendshme të saj, që nuk rrjedhin prej sllavishtes. Kështu prej fjalës *vërsë* (moshë) është formuar *vërsnik* (moshatar), prej fjalës *bisedë* fjala *bisedoj* etj.

Qëndrimi i sllavëve në Shqipëri ka lënë shumë gjurmë edhe në toponimi. Si dhe në të tjera vende të Ballkanit (Greqi, Traki, Maqedoni etj.) edhe në Shqipëri ka një tok emra katundesh, malesh e luginash, lumenjsh etj. që janë të burimit sllav. Sllavisti rus A. M. Selishçev, në fund të veprës së tij paraqet një hartë të emërtesës topografike sllave të Shqipërisë. Rrjeti më i dendur i emrave sllavë ndeshet në Veri, më fort në Dibër e në anët e Shkodrës, në Jug në rrethet e Beratit e të Vlorës (Myzeqe) e në krahinën e Korçës, në Leskovik e Përmet. Ndërsa emra krahinash le të përmendim, p.sh.: **Zadrime, Golemi, Tropoja, Velipoja, Çermenika, Çorovoda, Bistrica, Novosela, Osumi (lumë), Berati (nga Belgrad), Gollobërda etj.** Vetëm në rrethin e Peshkopisë numërohen rreth 80 emra fshatrash me origjinë sllave, siç janë Zimur, Bellovë, Rabdisht, Zagrad, Bigjunec, Pollozhan, Dohoshisht, Rashtnapojë, Brezhdan, Staravec, Sohodoll, Limjan, Shumbat, Cerjan, Vranjt, Dobrovë, Borovjan, Pjeçë, Shimçan, Reç, Sllatinë, Klenjë, Viçisht, Steblevë, Ostren, Kovashicë, Grezhdan, Kllobçisht, Tërbaç, Suhoriçan, Trepçë, Venisht, Jabllanicë, Krajkovishtë, Radivishtë, Sopot, Kolovisht, Godvijë, Çerkoviçan, Sebisht, Kërvaviç, Izvir, Sirpitovë, Vërnice, Gollovishtë, Godvi, Lubalesh, Radomirë. Kojavec, Krastë.

Vlen të shënohet se ndikimi sllav ndihet edhe në folklorin shqiptar. Hyjnë këtu disa figura të besimit popullor. Burim sllav është, p.sh., besimi i ngjalljes së të vdekurit, figura që janë emra sllavë, sipas krahinave Vurkolla (sllav. Vblkodlak-ujk) ose lugat. Edhe emri i dhampirit reflekton sllavisht vampire. E gurrës sllave është lubia, kuçedra e përrallave, emri i së cilës është një eufemizëm (sllav. Ijubiti (me dashtë). I atij burimi janë edhe gogoli e mora, si edhe buba, gogoli me të cilin trembin fëmijët.

Huazimet e shqipes në gjuhët sllave ballkanike sipas sferave të veprimitarisë

Elementet leksikore të shqipes në gjuhët sllave jugore karakterizohen nga një shtrirje e gjerë në sferat e jetës shoqërore, ekonomike, kulturore, familjare etj.

Shtrirja e këtyre elementeve në një varg sferash të veprimitarisë së fiseve sllave jugore, duke përfshirë aspektet më të rëndësishme të kulturës materiale e shpirtërore të tyre, tregon jo vetëm për lashtësinë e traditës kulturore shqiptare, por edhe një nivel të mirë zhvillimi e konsolidimi të saj në periudhën e kontakteve shqiptaro-sllave.

Elementi leksikor i shqipes në gjuhët sllave jugore tregon se kjo kulturë e lashtë materiale e shpirtërore, që ka ruajtur origjinalitetin e vet, asnjëherë nuk ka pasur karakter reliktor, të ngurtësuar. Sikurse kanë arritur në përfundim mjaft studiues, sidomos F. Nopça, kultura shqiptare gjatë gjithë zhvillimit të saj ka qenë një kulturë popullore dhe vepruese. Sipas sferave të veprimitarisë, elementet leksikore të shqipes në të folmet e gjuhëve sllave ballkanike paraqiten si më poshtë:

Shtëpia, ndërtimi dhe pajisjet e saj: buza, cilak, turin, bunjac, ksola, kulme, landa, plit, uluk, vatra, koltor, shkala, shkanj, perde, pus, taketuke, teshe etj.

Kuzhina, enët, gatimi: bl'ut, brenta, fiskija, goruzda, djum, kaca, kaçiçe, sheka, shpuzva etj., bazdore, bukuvale, felije, felkja, furna, klin (çorba), koloshtra etj.

Pamja, trupi, cilësitë trupore të njeriut: buza, bishç, cilak, turin, zurçka, lit, kuris, cava, buzina, buzonja, bajlosh, çkulie,

glembav , -a, çeçav, -a, çerozin, rumbulak, sangulat, shogan etj.

Cilësitë shpirtërore, ndjenjat, virtytet e larta: bujar, burinj, bustriç, cofnat, cup, fik, fodul, djal (gjallë), hajnik, heljmosan, katran, keçav, -a, kërcun, paçuk, çuça, çuçajka, çuçan, çuçave, shtrigosan, shtrigulja, torlek, trinë, shtrigan etj., deshproj (se), faqebard, koritnjau, krenija, krenishe (se), knaq, okinaqi (se), pal, uhabiti (se), okënaçio (sam se), ushprenjallo (mi se), vullnet etj.

Veshjet, stolitë, ngjyrat: barla, guna, gjatlok, komza, mafes, plis, pshtjelak, pula (pulja), çelesh, çuljah, xoxa (dyoka), xhupaljeta (dzupaljeta) etj., ruaska, gurdudzevair, izloçkosan, brubulak, arnisan etj., bojëkafe, bazast, barziv, kuçesh, mërk, murgav, mundze (munxhe) etj.

Higjena, sëmundjet: lera, loçka, shkuma, paçuçke, karpa, pljaga, flama, frus, pljagosan, sungulat, shoga, shtula, shurda, shuriga, tijerna, trenuo, trenut, umjek, tuta, tutkam (se), zgurdurio etj.

Marrëdhëniet familjare, fëmijët, lojërat: baca, bala, bija, binjak, bir birçe, cuca, çupa, fara, fis, kopilka, kopilij, kopilje, kumbare, kusherija, nipesha, nipçe, nusa, nusice, dada, dupi, foshnja, kalaman, kuta, koka, maca, shljaga etj., nuska, hipaljaka, gudza (guxa) etj.

Besimet, festat, zakonet popullore: fat, djama (gjama), djekati (gjekati), kaluer, kambanarija, kambanar, kambana, lugat, laso, monoshtir, murgesha, palavra, shtriga, zaropati (se) etj., koljendaj, kraçun (kraçunec) etj., kërpe (me kuptimin e ceremonisë së martesës), vsira, prika, ljulje, paj etj.

Jeta shoqërore, administratë, e drejta kanunore: faj, dorëzon, çpotka, gabonjan, kapedan, kuventa, mendore, merop, mik, peng, plak, pleqnuam, puna, çeveriija, sebar, soçnija, ushtarin, ureshititi, vulosa, zurma, pojak, shpotanje, porosija etj.

Bujqësia, kopshtaria, drurët: der, far, farija, frut, fusha, fang, kijak, kijem, kijaça, kashtar, kolomboç, lesa, pambuk, purilij, presha, shosha, shushljak, tuljina, vada, vija etj., trendafil, puljiza, protokol, pritka, dreteza, etj., venja, ljar, boçka etj.

Tokat sipas cilësive e konfiguracionit (thatësisë), ujërat, dukuri të natyrës: brina, çuka, kodra, kodrina, maçel, çafa, çufrana, çarma, suka, shpat, shtek, zal (zalo), gurishte, gurina,

karpa, shpela, rafsh, dret, fund, kunje etj., mil, liçen, dalga, ajr, circa, furtuna, posh koa, vapa etj.

Blegtoria, kafshët, emërtimet sipas cilësive e ngjyrave: disa vegla e objekte, bulmetrat: ber, cap, çeno, dashko, manar, mazga (mushka), maska, musla (mulo), magare, kec, kundra, kulish, sugare, tor, ugiç, maze etj, shiljak, shuta, cur, përc, balj, balja, baljast, baljash, baljav, balega, baljeshka, baljoshka, baljota, baljusha, bardoka, barziv, baljosh, brezast, brezak, brezka, kaleshka, kuçesh, murgo, muronja, murdze, laja, sora, pika etj., cingara, dzekeer (xekeer), djola (gjola), kërluk, mashna, trrçuk, straga (struga), tufa, kapistalo, kërpesh etj, ira (hira), koloshtra, ptin (tin) urda etj.

Shpend, peshq, insekte: birbil, çuba, gala, fuga, ijareza, patka, pulçe, utina etj., krap, krapuljiç, neperka, kërljesh etj.

Zeje, vegla, njerëzit sipas zejeve: copac, copaçe, daljta, deng, doganje (duganje), duç, ente, fasha, furka, kërpue, kut, stela, shara, sharati, shpirto, zumba (zumba), lepushkar (lopushkar), kaçar, sharaxhija, poçar, dzup (dzupa), zuza etj.

Lufta, mbrojtja: çkrepam (shkrepam) çomaga, shpata, degati (se), deshati (se), fishektor, firan, fit, trengjija, gvera, jeknuti (eknuti), kushtrim (edhe kalku: kojunak, konjunaci), luft, pljum, pranga (prange), pshtonit, çindronjao, çindrosat, rascoptan etj.

Elementet leksikore të shqipes kanë hyrë dhe janë ruajtur të gjalla kryesisht në ato dialekte e të folme të gjuhëve sllave, që kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë edhe sot në kontakte dhe marrëdhënie të drejtpërdrejtë me arealin e shqipes. Kësisoj janë disa të folme të serbishtes në Mal të Zi (Hot, Grudë, Plavë, Guci, Krajë, Ulqin, Tivar etj.), në Kosovë (në qendrat nga elementi serb e malazez), në disa treva të Serbisë jugore e juglindore, në Maqedoni (Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, Ohër etj.).

Elementet e shqipes në këto treva kanë hyrë në të folmet sllave nëpërmjet kontakteve herë të acaruara e herë paqësore, nëpërmjet marrëdhënieve ekonomike e shoqërore të fqinjësisë, duke përfunduar deri në martesë të përziera, si dhe në krijimin e mjediseve të dygjuhësisë.

Veç kësaj, ka mjaft fjalë që kalojnë caqet e ngushta të arsenalit të saj. Të tilla elemente ndeshen edhe në treva, që sot janë larg

truallit të shqipes, si: në Bosnjë-Hercegovinë, në Vojvodinë, në Dalmaci madje edhe në Slloveni.

Kjo ka ndodhur nëpërmjet lëvizjeve të vetë popullsisë sllave, si bartëse e këtyre elementeve të shqipes, nëpërmjet zhvendosjes e qarkullimit të njerëzve, familjeve dhe fiseve të tëra në drejtime të ndryshme. Gjithashtu, ka midis tyre në trevat ku janë ruajtur edhe sot e kësaj dite, siç kanë arritur në përfundim studiuesit K. Jireček, M. Shuflai etj., dikur aty nga mesjeta e vonë banonte një popullsi shqiptare ende e pasllavizuar. Në të mirë të këtij mendimi flet edhe fakti se në disa prej këtyre trevave, kur shqipja sot nuk flitet, janë ruajtur edhe mjaft elemente të onomastikës shqiptare, si : Brina, Omla, Malonsi, Gjinoviçi etj., në Dalmaci; Butmir, Ligatiçi, Tuçepi, Paraun, Perendia etj., në Bosnjë; Barzeta, Burmazi, Burmazoviçi, Podmol, Ujkiç, Sojniçi etj., në Hercegovinë etj.

Literatura e shfrytëzuar

1. Eqerem Çabej, *Vepra, vëllimi III*, Prishtinë, 1976, fq. 59-64-, 73-74.
2. Eqerem Çabej, *Vepra, vëllimi IV*, Prishtinë, 1977, fq. 335-373.
3. Sh. Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, fq. 46-47.
4. I. Ajeti, *Kërkime gjuhësore*, Prishtinë, 1978, fq. 341-373.
5. I. Ajeti. *Studime leksikore shqiptaro-sllave*, Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1968, Tiranë, 1969.
6. I. Ajeti. *Prania e shqipes ndër dialekte të popullsisë sllave të Gadishullit Ballkanik, në dritën e gjuhës dhe toponimisë së tyre*, Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1969.
7. I. Ajeti, *Për disa huazime shqiptare në të folmet serbokroate*, Studime filologjike, nr. 2, 1981.
8. S. Hoxha. *Elementet leksikore të gjuhës shqipe në gjuhët sllave ballkanike*, Shkodër, 2001, fq. 193-206.
9. J. Thomai. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974, fq. 158.
10. Xh. Ylli. *Mbi huazimet leksikore sllave në të folmet juglindore të Shqipërisë*, Studime filologjike, 1998, fq. 145-152.
11. J. Rexhepagiq, *Disa elemente të gjuhës shqipe në të folmen e popullsisë së Plavës*, Gjurmime albanologjike, Prishtinë, 1972.
12. M. Shuflai, *Serbët dhe shqiptarët*, Toena, Tiranë, 2004, fq. 158.